



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË

NR.REGJ.THEM.872

DATA E REGJISTRIMIT 22.10.2018

VENDIMI 5700/1

DATA 15.11.2018

V E N D I M
“NE EMER TE REPUBLIKES”



GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANË, E PERBERE NGA:

MARINELA OSMANI – GJYQTARE

Sot me date 15.11.2018, perfundoi ne shqyrtim kerkesen qe i perket:

KERKUES: Shoqata “IPA - Seksioni Albania”, perfaqesuar nga Presidenti i Shoqates Skender Doda.

OBJEKTI: Depozitim i vendimeve Nr.1, date 29.06.2018 dhe Nr.2, date 29.06.2018 te Shoqates “IPA - Seksioni Albania”.

BAZA LIGJORE: Kodi Civil, Ligji Nr.8788, date 07.05.2001 “Per organizatat jofitimprurese”, Ligji Nr.8789, date 07.05.2001 “Per regjistrimin e organizatave jofitimprurese”.

Gjykata, ne perfundim te shqyrtimit gjyqesor te kerkeses dhe te akteve bashkelidhur saj;

V E R E N

1. Me kerkesen drejtuar kesaj Gjykate, kerkuesi kerkon depozitimin ne rregjistrin e personave juridik, prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, te vendimeve Nr.1, date 29.06.2018 dhe Nr.2, date 29.06.2018 te Shoqates “IPA - Seksioni Albania”

Nga provat shkresore te paraqitura nga ana e pales kerkuese dhe aktet e depozituara ne Gjykate, rezultoi e provuar se:

2. Me vendimin Nr.5700, date 30.11.2017, Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane ka vendosur regjistrimin si person juridik te Shoqates “IPA - Seksioni Albania”.